



**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 24 Datë 16.02.2016**

**PËR**

**MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRIVE “EURON ENERGY”  
SH.P.K, “ENERGAL” SH.P.K DHE “ALB-ENERGY” SH.P.K PËR NJË  
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 133, DATË 31.10.2015 TË BORDIT TË  
ERE**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të nenit 26 “Rregullat e Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 21 , datë 18.03.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.02.2016, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërive “EURON ENERGY” sh.p.k “ENERGAL” sh.p.k dhe “ALB-ENERGY” sh.p.k për transferimin e pagesës së rregullimit të shoqërisë EURON ENERGY GROUP sh.p.k tek këto shoqëri, si dhe relacionin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

**Konstatoi se:**

- ERE me vendimin nr. 133, datë 31.10.2015 ka miratuar pagesat e rregullimit për vitin 2015, për të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike. Në tabelën e zërave (bashkëlidhur vendimit), rezultojnë detyrimet për pagesat e rregullimit për subjektet Alb-Energy” sh.p.k., “Euron Energy” sh.p.k. dhe “Energal” sh.p.k dhe Euron Energy Group sh.p.k.
- Shoqëritë Alb-Energy” sh.p.k., “Euron Energy” sh.p.k. dhe “Energal” sh.p.k. me shkresën me nr. 01 Prot. Date 04.01.2016 kane parashtruar kerkesen qe detyrimi per pagesen e rregullimit per vitin 2015 per shoqërinë “EURON ENERGY GROUP” sh.p.k. te shperndahet, sipas nje perqindje te caktuar, tek shoqëritë Alb-Energy” sh.p.k., “Euron Energy” sh.p.k. dhe “Energal”sh.p.k.

- “EURON ENERGY GROUP” sh.p.k ka pushuar aktivitetin e saj, dhe tashmë ka mbyllur edhe procedurat e likuidimit e çrregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit si dhe pranë organeve Tatimore.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Të miratojë kërkesën e shoqërive ‘EURON ENERGY’ sh.p.k, ‘ENERGAL’ sh.p.k dhe ‘ALB-ENERGY’ sh.p.k.
2. Në tabelën bashkëlidhur vendimit Nr. 133, datë 31.10.2015 të Bordit të ERE bëhet ndryshimi si më poshtë:
  - a) Hiqet nga Tabela subjekti “EURON ENERGY GROUP sh.p.k.
  - b) Vleres së pagesës se rregullimit per subjektet si me poshtë, i shtohet vlere në përqindje e detyrimit të “EURON ENERGY GROUP” sh.p.k. sic ishte në vendimin Nr. 133, datë 31.10.2015 të Bordit të ERE.
    - “Euron Energy” sh.p.k. 36.58%
    - “Energal” sh.p.k.sh.p.k. 16.26%
    - “Alb-Energy” sh.p.k. 47.16%
3. Drejtoria e Cmimeve dhe Tarifave të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare